

## KRITIKË E BIBLIOGRAFI

FJALOR BULLGARISHT-SHQIP. Përpiluar nga Th. Kacori, T. Tartari, L. Dusha, S. Pasko, L. Grabocka, nën redaktimin e akad. VI. Georgiev dhe R. Mutafçiev. Botim i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë. Sofje 1959, 888 f.

Kërkesat e sotme të marrëdhënieve ekonomike, tregëtare, politike, kulture, shkencore etj. shtrojnë përpara leksikografisë nevojën e hartimit të fjalorëve me qëllime praktike, që t'u shërbejnë këtyre marrëdhënieve, duke pasqyruar afërsisht në mënyrë objektive fjalët dhe shprehjet e përdorimit të përgjithshëm. Mendojmë se fjalori që kemi parasysh i përket këtij tipi fjalorësh.

Fjalori bullgarisht-shqip është botuar nga Instituti i Gjuhës bullgare i Akademisë së Shkencave të Bullgarisë. Ka 871 faqe fjalor, veç 9 faqeve të parathënies e shënimeve ndihmëse; është shtypur në letër të mirë dhe qartë, në një format të përshtatshëm, që e bën të lehtë punën me ndihmën e tij.

Dihet se fjalorë të vërtetë shqip-bullgarisht ose bullgarisht-shqip nuk ka patur përpara tij; për arsye të ndryshme aty-këtu ndeshen elementë fjalorësh për këto dy gjuhë në rasa e punime të tjera (si p.sh. tek fjalori greqisht-shqip-vllahisht-bullgarisht i Dhanilit të Voskopojës, Mihal Adam Haxhiut). Prandaj ky është i pari fjalor bullgarisht-shqip. Si i tillë, mund të thuhet që kemi përpara një fjalor të mirë. Aq më e drejtë do të dilte kjo, po të vështroheshin nga afër zgjidhjet e arritura në fjalor për detyrat, që dalin zakonisht para një fjalori dygjuhësh.

Janë zgjedhur e punuar fjalët më të nevojshme për të kuptuar bullgarishten e letërsisë artistike dhe të veprave shkencore, të shtypit e të radios, të bisedave të përditëshme e të shkollës, të industrisë e bujqësisë së re, të gjuhës së folur e nga leksiku i sferave të ndryshme të veprimtarisë shoqërore. Për këte zgjedhje hartuesit janë mbështetur me sa duket, në mes të tjerash në ndërtimin e glosarit të Fjalorit rusisht-shqip<sup>1</sup>, gjë që ka qenë e mundëshme dhe e dobishme edhe përse i përket trajtimit të problemeve të tjera, mbasi vëllimi i të dy fjalorëve (rreth 25.000 fjalë) përputhet plotësisht. Puna e hartuesve kështu është lehtësuar dhe ka patur përfundime të mira. Nga një krahasim i disa faqeve të para të germës s për të dy fjalorët, na doli se janë lënë jashtë fjalë si: санскрит, саркофар, състител, сегмент, секвестирам, семантичен, серенада, синод, синус, синхроничен etj. Fjalë të tilla, shpesh huazime të reja ose të sferave të ngushta speciale, me të drejtë mund të lihen jashtë një fjalori të tipit të vogël si glosar. Ka patur edhe një grup fjalësh, për të cilat hartuesit duhej të përpunonin një kriter të vetin të veçantë. Është fjala për turqizmat. Kundër tyre në të dyja gjuhët është bërë një luftë e gjatë, nga ana tjetër ato shpesh ruajnë po ato kuptime dhe përdorime, kështu që kuptohen lehtë nga folësit e të dyja gjuhëve; së fundi, një pjesë janë vjetëruar e po kufizohen ose dalin nga përdorimi i sotëm. Prandaj janë lënë jashtë fjalë si. аъши — вериш, аманет, байрак, вакъф, дамла, даяк,

1. Fjalor rusisht-shqip, Punuar nga Komisioni i Fjalorit rusisht-shqip i Seksionit të gjuhës e letërsisë, Instituti i Shkencave i R.P. të Shqipërisë, M. 1954.

дерман, гайле, гайрета, зимбил, такъм, ташия, хазър, хак, ханджар, саз, сайбия, сайансвам, сакън, сатрап, сахан, сахат, севад, сепр etj.

Shënojmë këtu vetëm që, për arësye të ruajtjes së proporcioneve të brendëshme, mund të ishte parë përfshirja e fjalëve si араба, харам, харч kur janë dhënë арабаджия, харамия, харча, ose халаал, хаил kur janë dhënë резил, хаал, кеф, хатър.

Zgjedhjes me kujdes dhe me kriter të glosarit në fjalor i përgjigjen edhe ndarja e kuptimeve të fjalëve dhe përkthimet përkatëse themelore, zakonisht të goditura krahas sinonimeve, duke mbajtur parasysh në një shkallë të caktuar veçoritë që i afrojnë dhe i dallojnë të dyja gjuhët; janë shfrytëzuar mirë mundësitë e mëdha të shqipes si gjuhë letrare, duke shoshitur e gjetur variantet më të përgjithëshme e më të përpikta. Nga pasuria e shembujve ilustrativë dhe e frazeologjisë popullore e të gjuhës së librave, ky fjalor mund të ngrihet deri në nivelin e fjalorëve të tjerë më të mirë dygjuhësh për shqipen.

Nga numri i mjaftë i shprehjeve dhe frazave të goditura po sjellim disa: matem me hijen e mëngjezit, me zemër të ngrirë, rri shtrembër dhe folë drejt, s'di t'i japë ujë gomarit, nuk ja var torbën, ujku qimen ndërron, zakonin s'e ndërron, hajdut me çizme, shkurti shkurton urët, marsi mbledh lëkurët etj. Po kështu çdo fjalë e marrë më vete na dëshmon për punën e hollësishme të bërë për të treguar përdorimin dhe jetën e fjalës në të folur e në gjuhën e gjallë. Mjaftojnë për këtë dy shembuj: për fjalën визам hyj në shtëpi, hyj në diskutim, hyj në luftë, hyj në sherr, nuk i hyn në kokë, hyj në punë, ligji hyn në fuqi, hyj në mëkatë, hyj në hollësira, hyj në kundërshtim, s'më hyn në punë etj.; për позиция pozita natyrale, pozicione mbrojtëse, ze pozicion, forcoj pozitat e mija, qëndroj i patundur në pozita marksiste etj.

Një problem leksikografik më vete është ai i mënyrës më të përnatatëshme për paraqitjen e kuptimeve të fjalës. Në fjalor për germën *a* dhe *o* është përdorur sistemi i ndarjes së kuptimeve me shifra arabe, psh. блясък 1. shkëlqim; 2 fig. madhështi, ndërsa më tej kuptimet nuk janë ndarë më, psh. връзка: lidhje, lidhëse, kravatë, spango, ndonëse në shënimet për përdorimin e fjalorit thuhet që kuptimet jepen me pikëpresje, ndërsa sinonimet ndahen vetëm me presje. Një pasqyrim i gjerë e i pasur i kuptimeve, përdorimeve e nuancave shpesh nga më të hollat të fjalëve, i shembujve, shprehjeve e frazave ashtu siç e gjejmë në fjalor, na duket se do të kërkonte dhe një shtjellim të strukturës semantike të fjalës sa më të përpunuar, sistematik dhe më të lehtë për t'u shfrytëzuar. Nuk kemi të bëjmë këtu gjithnjë me një çështje thjesht teknike. Le të marrim një shembull. Tek fjala таава jepet përkthimi kokë, krye, kapitull, pastaj në një renditje të rastit vijnë: nga bollëku kokë nuk të dhemb, i dal në krye, më erdhi në kokë; më tej: tallem prapa kurrizit, ka vënë kokën në torbët, kokë qepe, kokë lakër, kapitull libri, kryetar i familjes, kryetar i shtetit. Në një renditje të tillë jo vetëm është e vështirë të gjendet ajo që kërkohet, por edhe jepen mangët kuptimet e ngatërrohen me përdorimet frazeologjike. Kështu aty është fshehur kuptimi kryetar dhe kokërr, kokë. Do të kishte qenë shumë më mirë të ndiqej sistemi i dy germave të para, pra të ndaheshin kuptimet me shifra (ose ndryshe), të jepeshin për secilin kuptim sinonimet, pastaj shembujt për ilustrim e për përdorimet me nuanca dhe në fund frazeologjia përkatëse. Për shumicën e fjalëve nuk do të ishin fshehur kështu kuptimet, psh. tek сея do të dilte qartë që veç mbjell do të thotë edhe sit, pastaj këto në kuptim figurativ; për връзка që u tha më lart do të dilte i qartë kuptimi marrëdhënie dhe ai tufë etj.

Është e kuptueshme që edhe në numurin e madh të shprehjeve e frazave ka patur vend për diçka jo shumë të përpiktë. Janë dhënë nganjëherë variantet shqipe më pak të përhapura në vend të atyre që njihen gjerësisht, p.sh. kau lidhet për brirësh, kurse njeriu për fjalësh (për: burri); ve qylafin mbi sy (për: festen); as

*gjurmë* as nishan (për: *nam*); *bën* *dasmë* *me* *mall* *të* *botës* (për: *me* *miell* *hua*); *i* *mban* *goja* *erë* *qumësht* (për *i* *ka* *buzët* *me*); *ai* *është* *Ali*, *ai* *është* *kadi* (për: *vetë-vetë*) etj. Po ajo shprehje përkthehet ndryshe në dy raste: *si* *kofini* *pas* *të* *vjeli* (f. 122) dhe *si* *koshi* *pas* *të* *vjeli* (f. 219); *ka* *vënë* *kokën* *në* *torbët* (f. 79) dhe *futi* *kokën* *në* *torbë* (f. 755). Për disa shprehje bullgare nuk është dhënë saktë ajo shqipe, ose është dhënë përkthimi fjalë për fjalë, që nuk e zbërthen kuptimin e vërtetë të shprehjes, psh. për *всяка* *коза* *за* *свој* *крак* jepet *evgjitka* *lëvdon* *sitën* *e* *saj* (f. 239) dhe *o* *Mete* *për* *vete* (f. 655), ndërsa kemi shqip *berri* *varet* *për* *këmbën* *e* *tij*; për *гае* *e* *Киро* *на* *Кирия-три* *закара*, *два* *докара* jepet *e* *lirë* *kripa* *në* *Durrës*, *po* *e* *ha* *qira* *e* *udhës* (f. 220) ndërsa është fjala për një njeri, që s'e nxjerr qimen nga qulli ose që *vete* përlesh e kthehet i qethur; *на* *прехвадена* *ягоди* *с* *голяма* *кошница* *не* *ходи* përkthehet *një* *gjë* *që* *ta* *lëvdojnë* *shumë* *mos* *e* *beso*, kur kemi *ku* *dëgjon* *vezë* *shumë* *merr* *shportën* *e* *vogël* ose *ku* *bëhet* *dasmë* *e* *madhe* *merr* *lugën* *e* *vogël*; *каквато* *ме* *e* *залюляла*, *таква* *ще* *ме* *и* *долюле* përkthehet *si* *më* *ka* *tundur* *ashtu* *dhe* *do* *të* *më* *mbarojë* *së* *tunduri* kur kemi *si* *u* *nis* *do* *bitiset*, *si* *u* *nis* *do* *griset*. Ndoshta mund të shtoheshin edhe pak shprehje të njohura, si *kato* *на* *свина* *звънец* ose *kato* *на* *сврака* *трака* për *si* *shala* *gomarit* etj.

Përkthimi drejtpërdrejt nga bullgarishtja vihet re jo vetëm për frazat *si* *kуче* *влачи*, *диря* *няма* *të* *rrëmbyerit* *e* *qenit* *nuk* *ka* *gjurmë*, *глупав* *kato* *овен* *i* *patend* *si* *një* *dash* etj. Nganjëherë është tepër e vështirë të shkëputesh prej ndikimit të një gjuhe mbi tjetrën dhe na dalin raste si *виното* *има* *сладка* *жилака* *vera* *ка* *një* *dell* *ëmbëlsie*, *пускам* *в* *обращение* *lëshoj* *në* *qarkullim* (për: *ve* *në* *qarkullim*, *nxjerr* *në* *qarkullim*), *обедна* *стая* *dhoma* *e* *drekës* (për: *dhomë* *ngrenie*, *buke*), *обратен* *път* *rruga* *e* *praptë* (për: *rruga* *e* *kthimit*), *обричам* *някого* *на* *страдания* *nënshtroj* *ndonjerin* *në* *vuajtje* (për: *e* *le* *të* *vuajë*, *e* *bëj* *të* *heqë*, për më tepër po aty është ngatërruar *dedikoj* *me* *destinoj*) *правя* *си* *илузия* *bëj* *iluzione* (për: *kam* *iluzione*, *ushqej* *iluzione*, *më* *gënjen* *mendja*) etj.

Përfshirja në fjalor e termave dhe fjalëve më të reja, nga fushat më të ndryshme të jetës, ka kërkuar një punë të madhe nga ana e hartuesve për gjetjen e ekuivalenteve përkatëse të shqipes, të cilat nganjëherë nuk ndeshen as në fjalorët e botuar të shqipes. Zgjidhjet e drejta të arritura këtu e venë atë në një radhë me ata fjalorë të paktë gjuhë e huaj-shqip, tek të cilët ruhet i drejtë raporti i të dy gjuhëve. Dihet se numurit të caktuar të fjalëve të gjuhës së huaj duhet në fjalor t'i përgjigjet në rastin më të keq një numur po i tillë fjalësh të shqipes, ndërsa po të merren parasysh kuptimet e shumta të një fjale, sinonimet dhe variantet e mundëshme të përkthimit, ky numur duhet të jetë shumë më i madh. Vetëm kështu vihet në dukje thesari i të dy gjuhëve.

Disa pasaktësi që vihen re në fjalor mund të ishin evituar me një shfrytëzim më të mirë sidomos të Fjalorit të gjuhës shqipe (1954). Kështu *дойна* *крава* jepet *lopë* *që* *milet*, *që* *jep* *qumësht* ndërsa kemi *qumështore*; *обсерватория* jepet *observatorium* në vend të *observator*; *u* *siguruam* *me* *material* *djegës* (f. 382) për *me* *lëndë* *djegëse*, *червен* *вятер* është të *kuqtë* *e* *madh*, *foka* etj. Edhe për një varg rastesh të tjerë mund të ishte gjetur përkthimi i saktë: *словосочетание* nuk është *kombinim* i fjalëve; nuk thuhet shqip *gjuha* është *mbështjellja* *materiale* *e* *mendimit* por *veshja* *materiale* (tek *обвивка*); për *клепало* është dhënë një shpjegim i gjatë, kur kemi *çangë*; *войнице* *се* *окопават* *nuk* *do* *të* *thotë* *ushtarët* *zenë* *vend* *në* *llogore* por *ushtarët* *hapin* *llogore*, *грозосен*; *нечиста* *сила* *nuk* *është* *forcë* *e* *errët* por *i* *paudhi*, *qoftëlargu*; *говорим* *език* *si* *termë* *do* *të* *thotë* *gjuha* *e* *folur* *dhe* *jo* *që* *flitet*, *që* *përdoret*; *строителен* *обект* *nuk* *është* *objekt* *ndërtor* *njës* por *objekt* *në* *ndërtim* ose *ndërtimi*; *обстоятелство* *за* *място*, *време*, *начин* *nuk* *janë* *ndajfoljet*, por *plotësat* *përkatës* etj. Fjalë të tilla si *azhur* (në *financë*), *dëgjenerat*, *diskret*, *minucioz*, *omnipotencial*, *ashedent* etj. mund të mos ishin përdorur. Kemi ndeshur fjalë të papërkthyer, si *калкан*, *калина* (*butina* *e* *kuqe*).

Nganjëherë përkthimi ndeshet në vështirësi për shkak se nuk gjendet një fjalë e vetme përkatëse e prandaj do të jepet me disa fjalë. Në këtë rast togu duhet të na japë idenë e fjalës si nga ana semantike dhe nga ajo gramatikore. Kështu psh. *оглушки* nuk është një folje, siç del nga përkthimi *bëj veshin e shurdhër*, por si duket kemi një përdorim të lidhur frazeologjikisht në togun *права оглушки; самообразование* nuk është *autodidakt* por arësim *autodidakt*, puna për ngritjen *autodidakte*; *кръстосан разпит* jepet *kur të pyesin shumë veta njëkohësisht*, pra një fjali që nuk na jep idenë e emrit *marrje në pyetje*. Po kështu *ама* jepet si *pasthirmë*, ndërsa nga shembulli del se është lidhëz; tek ndajfolja *общо* është dhënë një shembull, ku kemi mbiemër: *нямам нищо общо с* etj. Për *ама* u përket emrave, në togjet me foljet e ndryshme mendojmë se do të kishte qenë e drejtë që në shqipen ata të jepeshin në trajtën e pashquar me një *një* përpara ose në trajtën e shquar, për të mos na dalë në çdo faqe të fjalorit ndërtime të tilla, që nuk ndeshen në shqipen: *qep kopsë, rrotulloj rrotë, ngas maqinë, më dolli emër*.

Edhe në parathënie theksohet që shqiptarët dhe bullgarët kanë jetuar në fqinjësi prej shekujsh në Ballkan. Gjurmët e kësaj fqinjësie duken më mirë se kudo në gjuhë. Marrja parasysh e afërisë gjuhësore të popujve të Ballkanit, e rezultateve të punimeve të veçanta shkencore për to, do ta lehtësonte punën dhe do ta bënte shumë më të përpiktë përmbajtjen e fjalorëve dygjuhësh brenda kësaj treve. Dihet psh. që fjala shqipe *besë* ka kaluar në gjuhët e tjera të Ballkanit, edhe në bullgarishten *беса* prandaj nuk dimë përse është lënë jashtë fjalorit, si edhe fjala *lek* (njësia monetare). Na duket pa vend futja e fjalëve *арнаутин* dhe *арнаутски* të përkthyer thjesht *arnaut*, i *arnautit* pa asnjë shënim ose shpjegim përkatës. Në fjalor gjejmë të ndara si homonime *беля*, *zbardh* dhe *беля qëroj* e po ashtu *белен* i *zbardhur* e *белен* i *qëruar*; mirëpo edhe në shqipen folja *zbardh* e ka kuptimin *qëroj*, *zbardh misrin*, prandaj ka të ngjarë të kemi të bëjmë me një zhvillim të rregulltë kuptimor dhe jo me homonimi. Edhe fjalët e huazuara shpesh i gjejmë në të dy gjuhët, prandaj psh. *хаса* nuk kishte përse të lihej lloj *pëlhure* kur gjejmë *hase* për kambrik, humahi, faqell në Fjalorin e gjuhës shqipe, e po këtu gjejmë edhe për *юфка -jufka*; për *шека* edhe në shqip përdoret *stekë* (bilaroje); folja *слизам* është një me shqipen *bie* e përdorur në këtë kuptim: *ai ka rënë mbrëmë te një mik*, etj. Një afëri e madhe vihet re edhe në frazeologji e mënyra shprehje, veç fjalëve e kuptimeve të veçantë. Prandaj tek *обница вѣтх* nuk kish përse të jepej *ta kesh për mësim* kur kemi shqip *ta vesh vëth në vesh*; *дсая мегдан с някого* është dhe në shqip *ndaj mejdanin* e jo *dal në dyluftim me ndonjë*, *ақ* më tepër po të mos harrojmë që kemi të bëjmë me një shtresë popullore e të folklorit dhe jo të gjuhës së librave, së cilës i përket *dyluftim* në shqipen; e kështu me radhë *върши разни магарии* është në shqipen *bëj gomarllëqe*, *хващам вяра* është *zë besë* etj.

Mjaft e diskutueshme është në leksikografi mënyra e trajtimit të homonimeve. Kështu psh. për *леща* thjerëz dhe lente, *агент* si njeri dhe si faktor, *акопа* në muzikë dhe për marrëveshje nuk mund të thuhet prerazi që kuptimet janë ndarë në homonime, prandaj diku jepen si një fjalë, kurse këtu dhe në fjalorë të tjerë i gjejmë si fjalë të veçanta. Për *крепостен* mendojmë se mund të flitej për dy homonime, pasi kuptimi historik është marrë nga rusishtja, ndërsa kuptimi tjetër lidhet me *крепост*. Mosndarja në dy homonime ka sjellë edhe përkthimin jo të drejtë të *крепостна стена*, që nuk është *mur feudal* por *mur i këstijellës*. Në disa raste ndarja në homonime është e qartë, prandaj nuk ka përse *метач<sub>1</sub>* — *метач<sub>2</sub>* të ndahen në homonime, ndërsa tek *метачка* të përzjehen, e po kështu *вреден<sub>1</sub>* — *вреден<sub>2</sub>* janë përzjerë tek *вредност*; *бой<sub>1</sub>* — *бой<sub>2</sub>* ndahen me të drejtë, porse tek *бой<sub>2</sub>* përsëri jepet si kuptim 1. *betejë*, Fjalët *бърда* 1,2; *бүхвам* 1,2; *бабя* 1,2 e disa të tjera nuk kishte përse të ndaheshin në homonime; edhe në fjalorët shpjegues të bullgarishtes i gjejmë si një fjalë e vetme me disa kuptime.

Në shkurtimet e përdorura në fjalor kemi një varg, që u përkasin sferave të përdorimit të fjalëve, fushave speciale të shkencës e teknikës, gjë që ndihmon shumë kuptimin e drejtë të fjalëve. Po aty jepen shënimet stilistike që janë përdorur. Brenda fjalorit, siç thuhet dhe në fillim, shënimet përdoren kryesisht për shprehjet dhe frazat e veçanta, më rrallë për fjalët. Prandaj kanë mbetur pa shënime përkatëse fjalë si: ачик, бои II, кмет, сефте, хал, ямб, яровизация, яшмак, юруш etj. Në parathënie thuhet: «Fjalori përmban fjalë të gjuhës letrare bullgare, si dhe disa fjalë dialektale dhe speciale, të cilat përdoren më tepër në bullgarisht». Mendojmë se për këto fjalë dialektale kërkohej një shënim i veçantë, pasi shkurtimet e përdorura *gjatë të folurit* dhe *fjalë popullore* nuk janë aq të qarta.

Megjithëse fjalori u është përmbajtur trajtave më të përbashkëta të shqipes, përsëri shquhet një farë hije e ndikimit të të folmeve krahinore të Korçës: ngatërrohen fjalët me *r* dhe me *rr*, hiqet ose shtohet *h* ku nuk duhet (*iqmu qafe* f. 270; *rregjistrohëni ketë* f. 232), veta e III e të kryerës së thjeshtë jepet me *-j* dhe jo me *-i* (*ai fitoj, çliroj*); edhe trajta e fjalë të tjera të veçanta na e tregojnë këtë: të *mbëdha*, *kjo* nuk do të *habisnjë* atë që e njuh (f. 870), shiu *halladiti* kopshtin (f. 380), kafshatë të madhe *haj*, po fjalë të madhe mos thua (f. 82), punët *muarën* tjetër drejtim (f. 354), a *kuptoji* (f. 114) etj.

Emrat gjeografikë janë dhënë në trup të fjalorit, megjithëse është bërë zakon në praktikën leksikografike të jepen në fund. Nuk do të kishte qenë keq të jepej edhe një listë e shkurtër e shkurtimeve kryesore që përdoren në bullgarisht, si *p.sh.* и п., и т.н., т.с. etj. po ashtu dhe për masat, dimensionet etj.

Nëse do të përpiqeshim të bënim një përgjithësim për gjithë sa u tha më sipër, nuk mund të mos theksonim edhe një herë, që puna e hartuesve, një punë shpesh mjaft e imtë dhe e lidhur me vështirësi të njohura, kur është fjala për të hapur rrugën në një drejtim, ja ka dalë të na japë një fjalor, që i afrohet nivelit të sotëm të kërkesave, të cilat shtrohen si nga nevojat e përdorimit praktik, ashtu edhe nga parimet e përgjithëshme leksikografike. Ndreqja e të metave të përmendura në këto radhë, si edhe marrja parasysh e vërejtjeve të tjera, nga ana e përdoruesve të fjalorit, në një ribotim do ta përmirësonte mjaft cilësinë, si dhe vlerën jo vetëm praktike, por edhe shkencore të fjalorit.

Xhevat Lloshi